



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M K.P.P. 102/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.03.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i procesit dhe mënyrës së vlerësimit dhe klasifikimit të ofertave të bërë nga Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-44292-11-20-2019, me objekt: *Loti II “Blerje ushqime koloniale për Konviktet e Shkollave të Mesme”*, me fond limit 2.558.018 lekë (pa-TVSH) zhvilluar më datë 06.01.2020, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, Tiranë.

Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Kadra” sh.p.k. dhe “Nelsa” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

“4 S” shpk.
Adresa: Lagjia “Xhevat Nepravishta”, Rruga “Çajupi”, pranë shkollës “Liri Kazazi”, Lushnje.

Autoriteti kontraktor:

Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, Tiranë.
Adresa: Rruga “Jeronim De Rada”, ish-konvikti i ekonomikut, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë

29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 21.11.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-44292-11-20-2019, me objekt: *Loti II “Blerje ushqime koloniale për Konviktet e Shkollave të Mesme”*, me fond limit 2.558.018 lekë (pa-TVSH) zhvilluar më datë 06.01.2020, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, Tiranë.

II.2. Në datën 06.01.2020 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 17.01.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Dogel” shpk	1796700,00 lekë	skualifikuar
2. “Gerti 1987” shpk	1896500,00 lekë	skualifikuar
3. “Kadra” shpk	1968300,00 lekë	kualifikuar
4. “Dajti Park 2007” shpk	2134500,00 lekë	skualifikuar
5. “Nelsa” shpk	2195700,00 lekë	kualifikuar
6. “Erdis” shpk	2220450,00 lekë	skualifikuar
7. “4 S” shpk	2526090,00 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 17.01.2020 operatori ekonomik “4 S” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.5. Në datën 23.01.2020 operatori ekonomik “4 S” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, ku kundërshton renditjen e bërë nga autoriteti kontraktor, si dhe kërkon skualifikimin e operatorëve ekonomikë “Kadra” shpk dhe “Nelsa” shpk me argumentet si më poshtë:

[...]Autoriteti kontraktor Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, më datë 21/11/2019 ka publikuar në sistemin elektronik të APP procedurën "E Hapur" me objekt "Loti i dytë Blerje ushqime koloniale për Konviktet e Shkollave të Mesme", me afat të dorëzimit të ofertave datën 06/01/2020. Shoqëria "4 S" shpk paraqiti ofertë në lidhje me këtë procedurë. Më datë 17/01/2020, autoriteti kontraktor publikoi në sistemin elektronik renditjen e operatorëve pjesëmarrës, e cila rezultoi si më poshtë:

<i>Operatorët ekonomikë</i>	<i>Vlera të ofetuara</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>DOGEL</i>	<i>1796700,00</i>	<i>Po</i>
<i>GERTI - 1987</i>	<i>1896500,00</i>	<i>Po</i>
<i>K A D R A</i>	<i>1968300,00</i>	<i>Jo</i>
<i>DAJTI PARK 2007</i>	<i>2134500,00</i>	<i>Po</i>
<i>NELSA</i>	<i>2195700,00</i>	<i>Jo</i>
<i>ERDIS</i>	<i>2220450,00</i>	<i>Po</i>
<i>4S</i>	<i>2526090,00</i>	<i>Jo</i>

Ne analizuam me kujdes klasifikimin e operatorëve ekonomikë dhe gjykojmë se ai është i padrejete dhe i pabazuar për arsyet si më poshtë:

1- Referuar klasifikimit të publikuar më datë 17/01/2020, KVO nuk e ka kryer vlerësimin e ofertave në bazë të shumatores së çmimeve për njësi, por në bazë të vlerës së përgjithshme të ofertës, e cila bie ndesh me kërkesat e dokumentave standarte të tenderit të publikuara nga vetë AK (pasi sasi të janë referuese) si dhe me parimet e zhvillimit të procedurës Marreveshje Kuadër.

2- Operatori KA D R A shpk i kualifikuar nga KVO, nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, konkretisht:

- Piken 2.3.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Ky operator nuk disponon ambjente të përshtatshme për tregtimin dhe magazinimin e mallrave objekt prokurimi në pronësi ose përdorim sipas kontratës noteriale të shoqëruar me Leje higjenosanitare dhe Certifikatë dezinfektimi 3D të vlefshme. Referuar edhe ekstraktit të QKB, ky operator ushtron aktivitet në vetëm një adresë, për të cilin në lotin e parë shoqëria KA D R A ka paraqitur dokumentacion për furrë të prodhimit të bukës dhe jo për magazinim të mallrave objekt prokurimi.
- Piken 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Ky operator nuk disponon në pronësi ose përdorim sipas kontratës noteriale mjet transporti ATP me dokumentacion të vlefshëm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të vërtetuar me: Leje qarkullimi, siguracion, taksa të mjetit, leje e transportit që lëshohet nga Bashkia, kontrolli teknik i mjetit, leje higjenosanitare, dhe certifikatë pronësie.

3- Operatori NELSA shpk i kualifikuar nga KVO, nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, konkretisht:

- Pikën 2.3.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Ky operator nuk disponon ambjente të përshtatshme për tregtimin dhe magazinimin e mallrave objekt prokurimi në pronësi ose përdorim sipas kontratës noteriale të shoqëruar me Leje higjenosanitare dhe Certifikatë dezinfektimi 3D të vlefshme.
- Pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Ky operator nuk disponon në pronësi ose përdorim sipas kontratës noteriale mjet transporti ATP me dokumentacion të vlefshëm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të vërtetuar me: Leje qarkullimi, siguracion, taksa të mjetit, leje e transportit që lëshohet nga Bashkia, kontrolli teknik i mjetit, leje higjenosanitare, dhe certifikatë pronësie.

Sa më sipër kërkojmë:

- Vlerësimin e ofertave në bazë të shumatores së çmimeve për njësi.
- Skualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria KA D R A shpk.
- Skualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria NELSA shpk.

II.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datën 25.01.2020 me shkresën nr.95 prot, operatori ekonomik ankimues “4 S” shpk është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 03.02.2020, pala ankimuese ankimues “4 S” shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtat pretendime si ato të parashtruara pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Njëpërmjet shkresës nr.142 prot, datë 10.02.2020, protokolluar me tonën me nr. 135/2 datë 11.02.2020, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “4 S” sh.p.k se: “1- Referuar klasifikimit të publikuar më datë 17/01/2020, KVO nuk e ka kryer vlerësimin e ofertave në bazë të shumatores së çmimeve për njësi, por në bazë të vlerës së përgjithshme të ofertës, e cila bie ndesh me kërkesat e dokumentave standarte të tenderit të publikuara nga vetë AK (pasi sasi të janë referuese) si dhe me parimet e zhvillimit të procedurës Marrëveshje Kuadër.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në “Njoftimin e kontratës” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, është përcaktuar:

2.3. *Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër*

Po Jo

2.4 *Lloji i Marrëveshjes Kuadër*

Me një Operator Ekonomik

Me disa operatorë ekonomikë

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po Jo

Në Marrëveshjen Kuadër me 1 Operator Ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, të jepen arsyet e përzgjedhjes së kësaj lloji Marrëveshje Kuadër.

Kjo procedurë po përzgjidhet nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme pasi të gjitha kushtet janë të përcaktuara (objekti, specifikimet teknike të mallit). Furnizimi me mall do të jete i përsëritshëm/i vazhdueshëm për një periudhë kohore prej 365 ditë.

Në zbatim të të përcaktimeve të Pikes 3.2.a të Udhëzimit nr.6, datë 16.01.2018 “Për përdorimin

e Marrëveshjes Kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, duke patur parasysh se të gjitha kushtet e MK janë të përcaktuara, numri i OE me të cilët do të lidhet MK do të jetë 1 (një) OE për secilin lot. Kjo me qëllim të sigurimit të vazhdueshëm të furnizimit me artikuj ushqimore mbajtjes së përgjegjësisë, si dhe për arsye teknike dhe organizative furnizimi me mall nga operatorë të ndryshëm nuk do të ishte i favorshëm, duke i shkaktuar autoritetit kontraktor problematikë në realizimin e kësaj kontrate.

2.5. Numri i operatorëve ekonomikë me të cilët do të perfundojë Marrëveshja Kuadër: 1 (një) (Këtu duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër).

2.6	Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronikë .	<p>Nuk do të ketë rihapje të konkursit.</p> <p>Kontratat do të lidhen sipas kerkesave të AK, me operatorin ekonomik me të suksesshëm, për secilin lot i cili do të ofrojë çmimin më të ulët të ofertës.</p> <p>Dhënia e kontratave do të bëhet nga Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme.</p> <p>Në rast të lindjes së nevojës konkrete për të lidhur një kontratë brenda marrëveshjes kuadër, Autoriteti kontraktor i kërkon operatorit ekonomik, fitues të lotit përkatës, të japë ofertën e tij.</p> <p>Komunikimi ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik, bëhet në formë të shkruar, ose elektronike (e-mail, fax, etj.) dhe në çdo rast duhet të dokumentohet dhe të bëhet pjesë e dosjes së procedurës.</p> <p>Sasitë e parashikuara janë vetëm sasi orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t'i blerë ato. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parashikuara. (por në çdo rast brenda vlerës së përlllogaritur të marrëveshjes kuadër).</p> <p>Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do t'i lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktor vendos të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të specifikuar dhe/ose në rast se autoriteti kontraktor vendos të mos blejë asnjë nga këto sasi për disa artikuj.</p> <p>Çmimet për njësi janë përcaktuar në Formularin e Çmimit të Ofertës. Çmimet e njësisive duhet të jenë fikse dhe nuk duhet t'i nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura në këtë marrëveshje kuadër.</p>
-----	--	---

2.7 Autoriteti kontraktor/Autoritetet kontraktore të cilat do të lidhin marrëveshjen kuadër: Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme

2.8 Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër me objekt: "Blerje Artikuj Ushqimore për Konviktet e Shkollave të Mesme për vitin 2020"

1. Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës : 13.986.704 (trembëdhjetëmilion e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtëmijë e shtatëqind e katër) lekë pa tvsh

2. Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, shumatorja e çmimeve për njësi është 8214.8 (tetëmijë e dyqind e katërbëdhjetë presje tetë) lekë pa T.V.SH

3. Fondi limit /Vlera e pritshme e kontratës i ndare ne lote si me poshte vijon:

a. Loti i parë: "Blerje buke për Konviktet e Shkollave të Mesme", me fond limit/ vlere te pritshme te kontrates 2.523.897 (dymilion e pesëqind e njëzet e tremijë e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.

b. Loti i dytë "Blerje ushqime koloniale për Konviktet e Shkollave të Mesme" me fond limit/ vlere te pritshme te kontrates 2.558.018 (dymilion e pesëqind e pesëdhjetë e tetëmijë e tetëmbëdhjetë) lekë pa tvsh. Shumatorja e çmimeve për njësi: 5325.5 (pesëmijë e treqind e njëzet e pesë presje pesë) lekë pa tvsh.

c. Loti i tretë: "Blerje ushqime blegtorale për Konviktet e Shkollave te Mesme" me fond limit/ vlere te pritshme te kontrates 7.322.472 (shtatëmilion e treqind e njëzet e dymijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa tvsh. Shumatorja e çmimeve për njësi: 2553.4 (dymijë e pesëqind e pesëdhjetë e tre presje katër) lekë pa tvsh.

d. Loti i katërt: "Blerje fruta perime për Konviktet e Shkollave të Mesme" me fond limit/ vlere te pritshme te kontrate 1.582.317 (njëmilion e pesëqind e tetëdhjetë e dymijë e treqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa tvsh. Shumatorja e çmimeve për njësi: 245.8 (dyqind e dyzet e pesëmijë presje tetë) lekë pa tvsh.

3. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit dhe buxheti i Bashkisë Tiranë.

4. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër "Blerje artikuj ushqimore për Konviktet e Shkollave të Mesme për vitin 2020" i ndare ne lote si më poshtë vijon:

- Loti i parë: "Blerje buke për Konviktet e Shkollave të Mesme"
- Loti i dytë "Blerje ushqime koloniale për Konviktet e Shkollave të Mesme"
- Loti i tretë: "Blerje ushqime blegtorale për Konviktet e Shkollave te Mesme"
- Loti i katërt: "Blerje fruta perime për Konviktet e Shkollave të Mesme"

Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik për secilin lot ku te gjitha kushtet jane te përcaktuara.

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) çmimi më i ulët X

Në shtojcën 1 "Formulari i ofertës ekonomike" është parashikuar:

Loti II "Blerje ushqime koloniale per Drejtorine e Konvikteve te Shkollave te Mesme"

Shtojca I

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-së

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

Fondi limit per Lotin e II / Vlera e pritshme 2.558.018 leke pa tvsh Shumatorja e cmimeve per njesi 5325.5 leke pa tvsh						
Nr .	Pershkrimi i mallrave	Njesi	Sasia e pritshme	Cmimi njesi pa tvsh	Cmimi total	Afati
	LOTI I DYTE					
1	ÇAJ MALI	kg	54			
2	FASULE	kg	1000			
3	SODË BUKE	kg	10			
4	SHEQER	kg	1500			
5	KRIPË	kg	1000			
6	LIMONTOZ	kg	10			
7	MAKARONA	kg	5000			
8	VAJ LULEDIELLI	litra	2000			
9	VAJ ULLIRI	litra	100			
10	MIELL	kg	1000			
11	NISESHTE	kg	200			
12	ORIZ	kg	5300			

13	PIPER KUQ+ZI	kg	50			
14	SALCE	kg	1000			
15	REÇEL	kg	1300			
16	RIGON	kg	9			
17	UTHULL	litra	300			
	Cmimi pa tvsh					
	TVSH 20%					
	Cmimi me tvsh					

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (kërkuar në dokumentat e tenderit)

2.6 Përcaktimi në dokumentat e tenderit se: “Nuk do të ketë rihapje të konkursit.

Kontratat do të lidhen sipas kerkesave të AK, me operatorin ekonomik me të suksesshëm, për secilin lot i cili do të ofroje cmimin me të ulët të ofertës.

Dhënia e kontratave do të bëhet nga Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme.

Në rast të lindjes së nevojës konkrete për të lidhur një kontratë brenda marrëveshjes kuadër, Autoriteti kontraktor i kërkon operatorit ekonomik, fitues të lotit përkatës, të japë ofertën e tij.

Komunikimi ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik, bëhet në formë të shkruar, ose elektronike (e-mail, fax, etj.) dhe në çdo rast duhet të dokumentohet dhe të bëhet pjesë e dosjes së procedurës.

Sasitë e parashikuara janë vetëm sasi orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t'i blerë ato. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parashikuara. (por në çdo rast brenda vlerës së përlogaritur të marrëveshjes kuadër).

Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do t'i lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktor vendos të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të specifikuar dhe/ose në rast se autoriteti kontraktor vendos të mos blejë asnjë nga këto sasi për disa artikuj.

Çmimet për njësi janë përcaktuar në Formularin e Çmimit të Ofertës. Çmimet e njësisë duhet të jenë fikse dhe nuk duhet t'i nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura në këtë marrëveshje kuadër.”.

III.1.3. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se autoriteti kontraktor ka bërë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të paraqitura, bazuar në cmimin total të ofertave, pa tvsh, si vijon:

- | | | |
|----------------------|-----------------|--------------|
| 1. “Dogel” shpk | 1796700,00 lekë | skualifikuar |
| 2. “Gerti 1987” shpk | 1896500,00 lekë | skualifikuar |
| 3. “Kadra” shpk | 1968300,00 lekë | kualifikuar |

4. “Dajti Park 2007” shpk	2134500,00 lekë	skualifikuar
5. “Nelsa” shpk	2195700,00 lekë	kualifikuar
6. “Erdis” shpk	2220450,00 lekë	skualifikuar
7. “4 S” shpk	2526090,00 lekë	kualifikuar

III.1.4. Në nenin 35/1, pika 5 dhe 8 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Kur një marrëveshje kuadër arrihet me një operator të vetëm ekonomik, kontratat e bazuara në këtë marrëveshje lidhen brenda kufijve dhe kushteve të parashtruara në marrëveshjen kuadër. Për prokurimin e këtyre kontratave, autoriteti kontraktor komunikon me shkrim me operatorin palë në marrëveshjen kuadër, duke i kërkuar atij të plotësojë ofertën, në përputhje me kërkesat.”.*

“Në çdo rast, marrëveshja kuadër zbatohet sipas përcaktimeve të parashikuara në rregullat e prokurimit publik.”

III.1.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 41, përcaktohet se: *“Marrëveshje kuadër quhet një marrëveshje ndërmjet një apo më shumë autoriteteve kontraktore dhe një apo më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është të vendosë kushtet e kontratave që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe, aty ku është e përshtatshme, me sasinë të parashikuara.”.*

Në nenin 45, pika 2 të këtyre rregullave përcaktohet se: *“Operatorët ekonomikë përzgjidhen si palë të marrëveshjes kuadër duke zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, sipas përcaktimeve të nenit 55, të LPP-së. Në çdo rast, autoriteti kontraktor mund të vendosë të vlerësojë ofertën/ofertat fituese duke u bazuar në çmimin për njësi.”.*

Ndërsa në nenin 47, pika 1 dhe 2, po këtu, parashikohet se:

“1. Marrëveshja kuadër mund të lidhet me:

a) një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara;

b) disa operatorë ekonomikë kur:

- të gjitha kushtet janë të përcaktuara;

- jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

2. Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Në kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk mund të bëhen ndryshime të kushteve për të cilat është lidhur marrëveshja, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e marrëveshjes kuadër. Nëse nevojat e autoritetit kontraktor ndryshojnë, atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re. Një operatori ekonomik i kërkohet të përgatitë ofertën e tij vetëm në lidhje me kushtet për të cilat është rënë dakord paraprakisht në marrëveshjen kuadër.”.

III.1.6. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.7. Referuar sa më sipër KPP gjykon se në dokumentat e tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar shprehimisht si kriter vlerësimi çmimin më të ulët të ofertës. Për më tepër, autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit nuk ka përcaktuar se vlerësimi i ofertave do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi, të përlllogaritur për çdo artikull.

Gjithashtu referuar Shtojces 1 “Formulari i ofertës” të dokumentave të tenderit është përcaktuar që operatorët ekonomikë të paraqesin preventivin e ofertës në bazë të shumatores së çmimeve për njësi edhe në vlerën totale të ofertës ekonomike, por kriter kryesor do të jetë çmimi më i ulët i ofertës.

Në rastin konkret autoriteti kontraktor ka vepruar siç ka njoftuar në dokumentat e tenderit, duke bërë renditjen e ofertave, bazuar në çmimin më të ulët të ofertës pa tvsh, sipas rregullave të vendosura nga ky i fundit në këto dokumenta, në përputhje me nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas të cilit autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në rast se operatori ekonomik ankimes do të kishte pretendime në lidhje me kerkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.”*

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me intepretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimes do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPPsë. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet*

brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”

Përsa më sipër, pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “4 S” sh.p.k. për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së shoqërisë “Nelsa” shpk, me arsyetimin se: “Operatori “Nelsa” shpk i kualifikuar nga KVO, nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, konkretisht: Pikën 2.3.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Ky operator nuk disponon ambjente të përshtatshme për tregtimin dhe magazinimin e mallrave objekt prokurimi në pronësi ose përdorim sipas kontratës noteriale të shoqëruar me Leje higjenosanitare dhe Certifikatë dezinfektimi 3D të vlefshme.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit të modifikuara, në shtojcën nr. 9, *Loti II: Blerje ushqime koloniale per Konviktet e Shkollave te Mesme*, pika 2.3.2 “Kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin: “2.3.2 Operatori Ekonomik duhet te kete ambjente te pershtatshme per tregtimin dhe magazinimin e mallrave objekt prokurimi, ne pronesi (vertetuar me akti i pronesise kopje e noterizuar) ose ne përdorim, sipas kontrates perkatëse noteriale shoqeruar me:

- *Leje Higjeno-Sanitare*
- *Çertifikate dezinfektimi 3D”.*

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Nelsa” sh.p.k, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, rezulton se në sistemin e prokurimeve elektronike kanë paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- *Kontratë noteriale qeraje nr.8923 rep, datë 18.11.2019, midis qeradhënësit N.B, pronar i pasurive “Ambient (magazinë) me sipërfaqe 234 m2, me numër pasurie 199/32-G1, vol.45, faqe 167, Zona kadastrale 2460, me adresë Dajt, Tiranë; Njësi me sipërfaqe 103 m2, me numër pasurie 199/32-N2, vol.45, faqe 171, Zona kadastrale 2460, me adresë Dajt, Tiranë dhe Njësi me sipërfaqe 208 m2, me numër pasurie 199/32-N1, vol.45, faqe 170, Zona kadastrale 2460, me adresë Dajt, Tiranë;” dhe qeramarrësit shoqëria “Nelsa” shpk, me afat 10 (dhjetë) vjet.*
- *Çertifikatë për vërtetim pronësie me nr. 1236419, datë 02.10.2015, me numër pasurie 199/32-N2 lloji i pasurisë njësi, me adresë Dajt, Tiranë, me sipërfaqe totale 103 m2, e lëshuar në emër të zotit N.B.*
- *Çertifikatë për vërtetim pronësie me nr. 1236421, datë 02.10.2015, me numër pasurie 199/32-N1 lloji i pasurisë njësi, me adresë Dajt, Tiranë, me sipërfaqe totale 208 m2, e lëshuar në emër të zotit N.B.*
- *Çertifikatë për vërtetim pronësie me nr. 1236423, datë 02.10.2015, me numër pasurie 199/32-G1 lloji i pasurisë garazh, me adresë Dajt, Tiranë, me sipërfaqe totale 234 m2, e lëshuar në emër të zotit N.B.*

- Akt miratimi higjeno sanitare nr. 1884, e lëshuar në datën 11.12.2015, për personin juridik N.B dhe “Nelsa” sh.p.k. me adresë Qesarak, Tiranë, me aktivitet Magazinë Produktet Ushqimore dhe Shtazore.
- Akt miratimi higjeno sanitare nr. 1883, e lëshuar në datën 11.12.2015, për personin juridik N.B dhe “Nelsa” sh.p.k. me adresë Qesarak, Tiranë, me aktivitet Magazinë Fruta-Perime.
- Dëshmi shërbimi (dezinfektim, dezinfektim, deratizim), lëshuar më datë 11.10.2019 për personin juridik “Nelsa” sh.p.k. pa adresë, me aktivitet Magazinë Ushqimore.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”.*

III.2.4. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”.*

III.2.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Operatori ekonomik “Nelsa” sh.p.k kanë paraqitur dokumentacionin e duhur në përmbushje të kriterit kualifikues, lidhur me patjen e një ambjenti të përshtatshëm për tregëtimin dhe magazinimin e mallrave objekt prokurimi, në pronësi (vërtetuar me akti i pronësisë kopje e noterizuar) ose në përdorim, sipas kontratës përkatëse noteriale shoqëruar me Leje Higjeno-Sanitare dhe Çertifikate dezinfektimi 3D, sipas përcaktimit të bërë nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, konstaton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në në shtojcën nr. 9, Loti II: Blerje ushqime koloniale për Konviktet e Shkollave të Mesme, pika 2.3.2 “Kapaciteti teknik”.

Së fundmi, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon gjithashtu se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse operatorët ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi disponojnë pajisjet e kërkuara dhe nëse këto janë të tilla ashtu siç kërkohen në dokumentat e tenderit. Për më tepër që autoriteti kontraktor ka parashikuar shprehimisht në dokumentat e tenderit se “Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të inspektojë në vend ambientet dhe pajisjet e sipërpërmendura, me qëllim verifikimin e plotësimit të kërkesave të sipërcituara”.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “4 S” sh.p.k. për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së shoqërisë “Nelsa” shpk, me arsyetimin se: “Operatori “Nelsa” shpk i kualifikuar nga KVO, nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, konkretisht: Pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Ky operator nuk disponon në pronësi ose përdorim sipas kontratës noteriale mjet transporti ATP me dokumentacion të vlefshëm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të vërtetuar me: Leje qarkullimi, siguracion, taksa të mjetit, leje e transportit që lëshohet nga Bashkia, kontrolli teknik i mjetit, leje higjenesanitare, dhe certifikatë pronësie.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit të modifikuara, në shtojcën nr. 9, *Loti II: Blerje ushqime koloniale per Konviktet e Shkollave te Mesme*, pika 2.3.2 “Kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin: “2.3.3 Operatori Ekonomik duhet te kete, Mjet transporti ATP, ne pronesi ose ne përdorim, sipas kontrates noteriale, te vertetuar me:

- leje qarkullimi,
- siguracion,
- taksat e mjetit,
- leje e transportit që lëshohet nga Bashkia,
- kontroll i mjetit,
- leje higjeno-sanitare,
- certifikate pronësie.”.

III.3.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Nelsa” sh.p.k, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, rezulton se në sistemin e prokurimeve elektronike kanë paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

Dokumentacionin e mjetit me targë AA978KU me kapacitet mbajtës 670 kg, si më poshtë vijon:

Leje qarkullimi, lëshuar për “Nelsa” shpk.

Certifikatë e kontrollit teknik të mjetit rrugor, e vlefshme.

Sigurimi i detyrueshëm i mjetit, e vlefshme.

Taksa vjetore, e vlefshme.

Certifikatë pronësie e mjetit në emërt të “Nelsa” shpk.

Vorë më datë 23.12.2015, për personin juridik “Kadra” shpk e vlefshme deri më datë 23.1.2020.

Akt miratimi higjeno-sanitar nr.74, datë 11.02.2015, lëshuar subjektit person juridik “Nelsa” shpk, për automjetin me targë AA978KU.

Kopje të nenit 28, i Udhëzimit nr.15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e leshimit të licensave autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, (i ndryshuar me Udhëzimin nr.5, datë 17.02.2011 të DPSHTRR-së.

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”.*

III.3.4. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”.*

III.3.5. Në nenin 28, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.3.6. Në nenin 46, Kreu II i Ligjit Nr.8308, datë 18.03.1998, *“Për transportet Rrugore”, i ndryshuar, ligjvënësi ka parashikuar:*

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për mjetet me kapacitet transportues nën 1500 kg.

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme

teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.3.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Nelsa” shpk, referuar dokumentit leje e qarkullimit të secilit mjet të paraqitur prej tyre, në të cilin konstatohen të gjitha të dhënat në lidhje me parametrat e mjetit, ndërmjet të cilave edhe kapaciteti mbajtës i mjetit, evidentohet si më poshtë:

- Për mjetin *ATP Mercedes Benz, me targa AA978KU*, në dokumentin *Leje Qarkullimi*, në pjesën *Përmbajtja*, në nr. Rendor 23 dhe 24 janë përkatësisht: Masa maksimale e autorizuar (kg) dhe Masa e mjetit bosh (kg).

Në po këtë dokument, në pjesën *Të dhëna mbi identifikimin e mjetit, Karakteristikat Teknike* evidentohet se në pikat respektive 23 dhe 24 janë të dhënat përkatësisht: 2590 dhe 1920. Nga verifikimi i të dhënave të evidentuara në këtë dokument në pikat 23 dhe 24 të saj, rezulton se kapaciteti mbajtës i këtij mjeti është më pak se 1500 kg.

III.3.9. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik “Nelsa” shpk nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar, pasi mungon vetëm leja e transportit që lëshohet nga bashkia, por nga verifikimi i të dhënave lidhur me kapacitetin mbajtës të automjetit në pronësi të tij nga ku rezultoi se kapaciteti mbajtës është nën 1500 kg dhe se referuar dispozitave ligjore të lex specialis, konkretisht Ligjit Nr.8308, datë 18.03.1998, “*Për transportet Rrugore*”, i ndryshuar, ku ligjvënësi ka parashikuar se këto dispozita nuk zbatohen për mjetet me kapacitet transportues nën 1500 kg, prandaj Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se edhe ky operator ekonomik ka paraqitur dokumentacionin e duhur në përmbushje të kriterit kualifikues të përcaktuar në shtojcën nr. 9, Loti II: Blerje ushqime koloniale për Konviktet e Shkollave të Mesme, pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, lidhur me disponimin e një mjeti në

pronësi ose më kontratë qeraje shoqëruar me dokumentacionin përkatës si: leje qarkullimi, siguracion, taksat e mjetit, leje e transportit që leshohet nga Bashkia, kontroll i mjetit, leje higjeno-sanitare dhe certifikatë pronësie, duke plotësuar këtë kriter kualifikues.

Së fundmi, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon gjithashtu se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse operatorët ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi disponojnë pajisjet e kërkuara dhe nëse këto janë të tilla ashtu siç kërkohen në dokumentat e tenderit. Për më tepër që autoriteti kontraktor ka parashikuar shprehimisht në dokumentat e tenderit se: *“Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të inspektojë në vend ambientet dhe pajisjet e sipërpërmendura, me qëllim verifikimin e plotësimit të kërkesave të sipërcituara.”*

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e ankimues “4S” sh.p.k. ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Kadra” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shyrtime, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi operatori ekonomik “Nelsa” sh.p.k., përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Kadra” sh.p.k., nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qënë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar.

Në këto kushte, KPP gjykon që pretendimet e ankimuesit nuk do të merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “4 S” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-44292-11-20-2019, me objekt: *Loti II “Blerje ushqime koloniale për Konviktet e Shkollave të Mesme”*, me fond limit 2.558.018 lekë (pa-TVSH) zhvilluar më datë 06.01.2020, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, Tiranë.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 135 Protokoli; Datë 03.02.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha